

LIGJ
Nr. 153/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8550, DATË 18.11.1999
“STATUSI I DEPUTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Deputeti takohet periodikisht me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata. Deputeti i përfaqëson ata duke iu marrë mendime apo duke iu dhënë shpjegime për projektligje, amendamente, vendime, rezoluta apo deklarata që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend.”.

Neni 2

Në nenin 6, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organet e qeverisjes vendore dhe prefekturat, në fillim të çdo muaji, njoftojnë deputetët e qarkut ku ata janë zgjedhur për kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë ndryshimet e mundshme që mund t'i bëhen atij.”.

Neni 3

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

1. Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, nga ministrat ose nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore, si dhe nga drejtuesit e çdo institucioni tjetër në administratën publike ose të qeverisjes vendore.

2. Drejtuesit e institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Në rast shkeljeje të pikës 2 të këtij neni, njoftohet Kryeministri për të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse. Në rastet e enteve apo institucioneve të tjera qendrore, njoftohet organi prej të cilit ato janë zgjedhur.”.

Neni 4

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, në ministri ose në institucione të tjera qendrore dhe vendore, kur në to shqyrtohen probleme të ngritura prej tij dhe që lidhen me qarkun ku është zgjedhur.”.

Neni 5

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

1. Organet shtetërore dhe vendore janë të detyruara të marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit, të cilat i paraqiten atyre nëpërmjet deputetit.

2. Këto organe, brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së tyre, detyrohen të njoftojnë deputetin për mënyrën e trajtimit apo zgjidhjes së tyre.”.

Neni 6

Në nenin 11, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur deputeti konstaton se një akt normativ i Këshillit të Ministrave, ministrive, institucioneve qendrore, organeve të qeverisjes vendore ose i administratës publike është i kontestueshëm, i propozon me shkrim organit përkatës rishikimin ose shfuqizimin e tij.”.

Neni 7

Në nenin 13, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura e deputetit në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare sjell ndalesën e pagës ditore.”.

Neni 8

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

1. Komisionet, grupet parlamentare dhe deputetët kanë zyrat e tyre pranë selisë së Kuvendit me stafet e tyre ndihmëse.

2. Kuvendi, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, hap në çdo rreth zyra të veçanta për deputetët e maxhorancës dhe opozitës, për çdo rast që ato kanë përfaqësim. Në rrethet ku ka përfaqësim vetëm të njëjës palë hapet vetëm një zyrë.

3. Kryetari i Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, emëron në zyrat përkatëse një specialist, si rregull me arsim të lartë juridik. Kuvendi pajis zyrat me mjetet e nevojshme të punës.

4. Fondet për nevojat e mësipërme përballohen nga buxheti i Kuvendit.”.

Neni 9

Në nenin 23 paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.5.2013

Shpallur me dekretin nr.8216, datë 4.6.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani